



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Emri i Biznesit: D.P.SH. "EAGLE"

Numri i biznesit: 810601519

Pronar: Mustafa BRUTI

Operatori i Shpërndarjes: EAGLE

Adresa: Haki Taha, Nr.1, Prizren



VENDIM

për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Operatorit të Shpërndarjes EAGLE, me seli në Prizren

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. EAGLE është operatorë i shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes rrjetit kabllorë, në pajtim me Rregullorën KPM-2020/01, me seli në Prizren. KPM, me datën 1 gusht 2008, ka marr vendim për dhënien e licencës për Operatorin e Shpërndarjes EAGLE.
3. Më datën 31 maj 2021, pronari i operatorit të shpërndarjes EAGLE, përmes një shkrese të dorëzuar në KPM, ka njoftuar se heqë dorë nga licenca e operatorit të shpërndarjes.


Arsyetimi

4. Duke u bazuar në njoftimin e pronarit të operatorit të shpërndarjes EAGLE, për heqje dorë nga licenca në mënyrë vullnetare, Komisioni vlerëson se ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së operatorit të shpërndarjes EAGLE.

Vendim

5. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 29 korrik 2021, merr vendim për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Operatorit të Shpërndarjes EAGLE, me seli në Prizren, sipas njoftimit për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga Licenca e KPM-së, ndërsa obligimet financiare të këtij operatori të shlyhen në pajtim me legjislacionin në fuqi.

6. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



29.07.2021
datë